



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:107392  
Datë: 16.05.2023  
Numri i dokumentit: 04283787

**PA1.nr.390/2023**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** – kolegji i përbërë nga gjyqtarët Abdullah Ahmeti, kryetar i kolegjit, Skender Çoçaj dhe Zyhdi Haziri, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Rrezarta Bala si procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të akuzuarit V. S. , nga M, për shkak të veprës penale Sulmi, nga neni 184 par.2, të KPRK-së, për të vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit V. S. , av. E. I. , të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, P.nr.185/22, të datës 15.12.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur, me datë 05.05.2023, mori këtë :

**A K T G J Y K I M**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit V. S. av. E. I. , ndërsa aktgjykimi Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri, P.nr.185/22, të datës 15.12.2022, **vërtetohet**.

**A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, me aktgjykimin P.nr.185/22, të datës 15.12.2022, të akuzuarin V. S. , e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale Sulmi, nga neni 184 par.2, të KPRK-së dhe i ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. E dëmtuara A. T. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civilo juridik. Detyrohet i akuzuari që në emër të paushallit të paguaj shumën prej nga 30 euro si dhe shumën prej 30 euro për fondin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur:

Mbrojtësi i të akuzuarit V. S. , av. E. I. , për shkak të vendimit mbi sanksionin penal me propozim Gjykata e Apelit e Kosovës, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj dhe të akuzuarit të i shqiptoj dënim me kusht.

Prokurori i Apelit, me parashtrësën me shkrim PPA/II.nr.430/2023 të datës 24.03.2023, ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit V. S. av. E. I. , ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit konform nenit 390 të KPPRK-së caktoi dhe mbajti seancën e kolegjit në të cilën nuk mori pjesë Prokurori i Apelit, ndërsa morën pjesë mbrojtësi i të akuzuarit av. E. I. , i cili deklaroi se qëndron pranë ankesës së ushtruar me shkrim, me propozim që të akuzuarit të i zbutet dënimi, i akuzuari V. S. , deklaroi se e mbështet në tërësi ankesën e mbrojtësit të tij, me tej shton se është penduar, me propozim që të i zbutet dënimi, e dëmtuara A. T. , deklaroi se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale si dhe nuk kërkon dëmshpërblim, duke shtuar se nuk ndjehet e kërcënuar, se jeton së bashku me të akuzuarin, i kanë rregulluar raportet si dhe nuk kanë më probleme.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridike penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPPRK-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

**-Ankesa është e pabazuar.**

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës së nenit 394 të KPPRK-së dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit, e të cilat do kishin kushtëzuar anulimin e tij.

Mbrojtësi i të akuzuarit V. S. av. E. I. e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për shkak të vendimit mbi dënimin, duke theksuar se i akuzuari e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestarë andaj gjykata është dashur të merre parasysh rrethanat lehtësuese siç janë rrethanat personale se është mbajtës i familjes, është person që punon për familjen shtatë anëtarësh prej tyre dy fëmijë të mitur, bashkëpunimin e të akuzuarit me organet drejtësisë, i njëjti ka shfaqur keqardhje para gjykatës dhe ka premtuar se nuk do të përsërit kurrfarë vepre penale të çfarëdo natyre çoftë e aq më pak veprën penale për të cilën e ka pranuar fajësinë dhe është penduar tej mase. Gjykata në këtë rast do të duhej ti shqiptonte dënim me kusht duke u bazuar në dispozitat ligjore, ka shtuar se i akuzuari tani është pajtuar me të dëmtuarën të cilën e ka bashkëshorte dhe jetojnë së bashku duke u përkujdesur për fëmijët e mitur, dhe ekzekutimi i dënimit me burgim do të kishte efekt negativ ku do të ndikonte direkt në mirëqenien ekonomike dhe sociale të akuzuarit dhe familjes së tij.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se pretendimet ankimore të mbrojtjes nuk janë të bazuara, kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa në ankesën e lartcekur nuk është paraqitur ndonjë rrethanë e rëndësishme dhe e posaçme që nuk është vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë, e cila do ta arsyetonte shqiptimin e dënim më të butë. Kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit i pati parasysh rrethanat, ku si rrethanë rënduese ka marrë shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, pasi që vepra penale është kryer me dashje, intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur përkatësisht integritetin truporë të dëmtuarës, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, sjelljen e më parshme të akuzuarit pasi që i njëjti është recidivist i veprave penale të ndryshme, ndërsa si rrethanë lehtësuese ka marrë pranimin e fajësisë nga i akuzuari, e bazuar në këto rrethana i ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar me bindjen se edhe me një dënim të tillë do arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së. Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, rrethana këto të cilat, sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, andaj duke marrë parasysh rrethanat e konstatuara dhe drejtë të vlerësuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, del se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se kjo do t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me këtë kryerësit do të parandalohen nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të bëhet rehabilitimi i tyre. Andaj kolegji penal i kësaj gjykate konsideron se dënimi i shqiptuar është i mjaftueshëm për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
PA1.nr.390/2023, më datë 05.05.2023

**Procesmbajtëse,**  
Rrezarta Bala

**Anëtarët e kolegjit:**  
Skender Çoçaj

**Kryetar i kolegjit,**  
Abdullah Ahmeti

Zyhdi Haziri